



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORI

Nr. 601 prot.

Tiranë, më 07.03.2025

UDHËZIM
Nr. 1, datë 07.03.2025

PËR
“PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE PRANIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË
TË STUDIMEVE “DOKTORATË” NË NJËSITË KRYESORE TË UNIVERSITETIT TË
MJEKËSISË, TIRANË PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025”

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” nenet 77, 78 dhe 79; Vendimin e KM nr. 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar, Kreu I; Statutin e UMT-së, nenet 5, 88 dhe 89; Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, neni 70; Rregulloren “Për organizimin e programeve të studimit të doktoratave” e ndryshuar; Udhëzimin e MAS nr. 52, datë 3.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimit në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar; Vendimin e Senatit Akademik të UMT-së nr. 83, datë 24.05.2024 “Për miratimin e kuotave të pranimit për programet e ciklit të tretë të studimeve “Doktoratë” për vitin akademik 2024-2025, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” si dhe shkresën e MAS me nr. 8057/1 prot., datë 22.01.2025, “Mbi listën e udhëheqësve në programet e studimit të ciklit të tretë në doktoratë, për vitin akademik 2024-2025”,

UDHËZOJ:

I. Kërkesat themelore për regjistrimin e kandidatëve

1. Për t’u regjistruar në një program studimit të ciklit të tretë të doktoratës, aplikanti duhet të përmbushë këto kriterë të përgjithshme:
 - a) Të ketë përfunduar studimet e larta në fushën e kërkuar dhe të zotërojë një diplomë të nivelit të dytë, një diplomë të integruar të nivelit të dytë ose një diplomë të barasvlershme sipas sistemit të vjetër, të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente;
 - b) Të zotërojë me dëshmi një prej 5 gjuhëve të huaja të BE-së të paktën në nivelin B2 (Anglisht, Gjermanisht, Spanjisht, Italisht, Frëngjisht), në përputhje me Udhëzimin përkatës të Ministrisë përgjegjëse për arsimin;
 - c) Të ketë notë mesatare të ponderuar të ciklit të dytë mbi 8 (tetë). Për aplikantët që kanë diplomë të barasvlershme sipas sistemit të vjetër, bëhet përlllogaritja e mesatares së ponderuar nga

komisioni përkatës në njësinë kryesore brenda 3 (tre) ditëve pune nga përfundimi i afatit të aplikimit.

- d) Të paraqesë projekt individual kërkimor-shkencor në përputhje me fushat kërkimore të përcaktuara nga njësia bazë;
- e) Të dëshmojë nëpërmjet projekt idesë/planit individual kërkimor, njohuri dhe aftësi për:
- Të menduarin krijues;
 - Sensin kritik të zhvillimit të fushës së kërkimit;
 - Lidhjet midis fushave të kërkimit;
 - Zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës kërkimore;
 - Kompetencë në menaxhimin e kompleksitetit e kërkimit dhe ideve të reja.
- f) Të ketë dy rekomandime për këtë aplikim, me vlerësime pozitive nga persona, që kanë titullin akademik “Profesor i Asociuar” ose “Profesor”, të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit;
- g) Të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij apo të mos jenë gjetur shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës, si edhe shkelje të kodit deontologjik profesional;
- h) Të vetëdeklarojë se, është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike;
- i) Të mos jetë duke ndjekur një program tjetër studimi.
2. Njësitë bazë mund të propozojnë edhe kritere preferenciale të tilla si:
- a) Preferohet të punojë në fushën përkatëse. Prioritet kanë personeli akademik me kohë të plotë në njësitë bazë të UMT-së;
- b) Preferohet të ketë përfunduar specializim afatgjatë në fushën përkatëse;
- c) Preferohet të ketë eksperiencë në mësimdhënie në fushën përkatëse;
- d) Preferohet të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore si dhe të ketë botime në fushën përkatëse.
3. Në vlerësimin e kandidatëve, merren në konsideratë kriteret e miratuara, sipas raporteve në vijim:
- | | |
|---|---------|
| a) Nota mesatare e ponderuar e studimeve të ciklit të dytë | 20 pikë |
| b) Projekt propozimi për kërkimin shkencor | 30 pikë |
| c) Eksperienca në mësimdhënie | 10 pikë |
| d) Veprimtaria botuese, pjesëmarrja në projekte kërkimore | 10 pikë |
| e) Eksperienca profesionale | 10 pikë |
| f) Kualifikime shkencore/profesionale (specializim, master ekzekutiv, trajnim mbi 6 muaj pa ndërprerje) | 10 pikë |
| g) Kritere të tjera preferenciale të vendosura nga njësia bazë/njësitë bazë | 10 pikë |

II. Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatët aplikantë për t’u pranuar në programet e studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në UMT

Kërkesa e aplikantit, drejtuar njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit të doktoratës, në të cilën theksohet propozimi për temën, është dokumenti fillestar i aplikimit i cili përmban bashkëngjitur edhe dokumentet e mëposhtme:

1. *Curriculum Vitae* personale dhe bibliografi të punimeve shkencore, të cilat duhet të jenë të dokumentuara, nëse aplikanti ka të tilla;

2. kopje të noterizuar të diplomave të kërkuara sipas pikës I/1/a, shoqëruar me listën e notave apo suplementin e diplomës. Diploma e huaj shoqërohet me vërtetimin e njohjes nga Ministria përgjegjëse për arsimin;
3. kopje të noterizuar të diplomave apo certifikatave të kualifikimeve të ciklit të tretë apo të një diplome ose certifikate të barasvlershme me to, shoqëruar me listën e notave apo suplementin e diplomës, nëse kandidati zotëron një të tillë;
4. fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës;
5. 2 (dy) fotografi;
6. 2 (dy) rekomandime nga personel me titull akademik në fushën e shëndetit lidhur me këtë aplikim, të lëshuar brenda 3 muajve të fundit;
7. një deklaratë që pranon të shlyejë të gjitha detyrimet financiare lidhur me koston e këtyre studimeve, në rastet e vetëfinancimit, (Deklarata nr. 1);
8. dëshmi të gjuhës/gjuhëve të huaja të paktën në nivelin B2 (Anglisht, Gjermanisht, Spanjisht, Italisht, Frëngjisht);
9. vërtetim nga qendra e punës, nëse është i punësuar, që dëshmon se aplikanti është personel akademik ose personel i përfshirë në kërkim shkencor;
10. deklaratë e një prej udhëheqësve shkencorë të miratuar në programin përkatës të studimit se, projekti i kërkimit shkencor të propozuar nga kandidati është i përshtatshëm për aplikimin për studime të doktoratës në këtë program. Një udhëheqës shkencor mund të lëshojë më shumë se një deklaratë udhëheqjeje;
11. vendimi i njësisë bazë për fushat e kërkimit shkencor të njësisë, sipas publikimit në faqen zyrtare të njësisë kryesore;
12. vendimi i njësisë bazë për dokumentacionin e kërkuar për aplikim, sipas publikimit në faqen zyrtare të njësisë kryesore;
13. propozimi i kërkimit shkencor, ku të evidentohen objektivat e kërkimit shkencor, metodologjia që do të ndiqet, nevoja për studim të thelluar në fushën e propozuar dhe risitë, që pritet të sjellë punimi, platforma/plani i punës kërkimore-shkencore i ndarë në vite, si dhe mundësia që studimi të mbulohet nga grante kërkimore-shkencore, hartuar dhe nënshkruar nga kandidati;
14. vetëdeklarim i aplikantit se nuk ka patur në të kaluarën shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës, si dhe që do të zbatojë standardet shkencore dhe etike, (Deklarata nr. 2).
15. vetëdeklarim i aplikantit se, nuk është duke ndjekur një program tjetër studimi, (Deklarata nr. 3).
16. mandat pagesa për tarifën e aplikimit sipas Vendimit përkatës të Bordit të Administrimit të UMT-së.

Dokumentacioni duhet të dorëzohet i inventarizuar në dy kopje, një prej të cilave shoqëron dosjen dhe kopja tjetër i jepet kandidatit.

III. Procedura e shpalljes, aplikimit dhe pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve të doktoratës

1. Njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë organizojnë procesin e aplikimit, pranimit dhe regjistrimit në programet e studimeve të ciklit të tretë të doktoratës.

2. Njësitë bazë përcjellin në Dekanat kriteret preferenciale të vlerësimit të kandidatëve, sipas përcaktimeve në pikat I/2 dhe I/3, të këtij Udhëzimi, jo më vonë se 3 (tre) ditë pune përpara hapjes së aplikimeve në këto programe.
3. Njësitë kryesore, bëjnë publikimin e kriterëve, procedurave dhe afateve për konkursin e pranimit në programet e studimit të doktoratës, në faqet zyrtare të internetit të çdo njësie kryesore dhe të UMT-së, të paktën 1 (një) muaj përpara përfundimit të afatit për depozitimin e kërkesave.
4. Njoftimi publik në faqen zyrtare të çdo njësie kryesore dhe të UMT-së, duhet të përmbajë listën e programeve të studimit të doktoratës sipas fakulteteve përkatëse; numrin e kuotave sipas fushave dhe nënfushave (*sipas Vendimit të Senatit Akademik të UMT nr. 83, datë 24.05.2024*); fushat e kërkimit, listën e udhëheqësve shkencorë, kriteret e përgjithshme dhe ato preferenciale; dokumentacionin që kandidati duhet të dorëzojë; afatin dhe mënyrën e dorëzimit të dokumentacionit, si dhe procedurat e vlerësimit të kandidatëve. Njoftimi publik duhet të jetë i shprehur qartë, të mos lërë vend për keqkuptime dhe/ose interpretime në asnjë prej elementëve të tij.
5. Kandidatët të cilët aplikojnë në një program studimi të ciklit të tretë “Doktoratë” në UMT, dorëzojnë aplikimet e tyre në zyrën e protokoll arkivës të njësisë kryesore përkatëse, sipas përcaktimeve në njoftimin publik, fizikisht ose nëpërmjet shërbimit postar. Në rastin e aplikimit përmes shërbimit postar, data në vulën e shërbimit postar do të shërbejë për të përcaktuar respektimin e afateve të aplikimit. Dokumentacioni duhet të jetë i inventarizuar sipas numrit të dokumenteve dhe faqet përkatëse.
6. Përpara datës së mbylljes së aplikimeve, Dekanati publikon afatet e shqyrtimit të dosjeve në faqen zyrtare të njësisë kryesore.
7. Jo më vonë se 1 (një) javë pas përfundimit të datës së aplikimeve, njësia kryesore bën publike listën e aplikantëve (*të anonimizuar me ID përkatëse*) dhe i përcjell njësisë bazë përkatëse dosjet e aplikimeve të kandidatëve për programet e doktoratës.
8. Komisionet *ad hoc* të vlerësimit ngrihen jo më vonë se 1 (një) javë para datës së përfundimit të aplikimeve dhe përbëhen nga të gjithë anëtarët e njësisë bazë, që mbajnë titullin akademik “Profesor” ose “Profesor i Asociuar” dhe drejtohen nga përgjegjësi i njësisë bazë. Në rastet e programeve me nënfusha specifike, dekanati mund të ngrejë komisione *ad hoc* sipas nënfushave, përbërja e të cilëve është nga jo më pak se 3 (tre) anëtarë. Përbërja e komisioneve i njoftohet Rektoratit jo më vonë se 3 (tre) ditë pune nga ngritja e tyre. Në rastet kur njësitë bazë bashkëpunojnë për organizimin e programit të studimeve të ciklit të tretë të doktoratës, komisioni *ad hoc* mund të ngrihet në nivel njësie kryesore dhe udhëhiqet nga përgjegjësi i programit.
9. Përparësi në përzgjedhjen e kandidatëve, në programin e studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në UMT, ka personeli akademik me kohë të plotë në UMT; personeli akademik me kohë të pjesshme në UMT; kandidatët e tjerë të punësuar si personel akademik në institucionet e tjera publike dhe jopublike të arsimit të lartë, apo personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar, pranë institucioneve të arsimit të lartë të llojit “universitet” ose “akademi” në RSH.
10. Brenda 5 (pesë) ditëve pune Komisioni *ad hoc*, verifikon përmbushjen e kriterëve themelore, bën përzgjedhjen dhe renditjen e kandidatëve, sipas fushave/nënfushave të programeve të studimit të doktoratës, mbështetur në propozimin e aplikantit dhe në dokumentacionin në dosjen

përkatëse, referuar një liste të qartë dhe transparente mbi pikëzimin e kritereve specifike të aplikantëve.

11. Lista e kandidatëve (*e anonimizuar me ID përkatëse*), të përzgjedhur e të listuar në rend zbritës nga Komisioni ad hoc miratohet në mbledhjen e njësisë bazë dhe përcillet për publikim paraprak tek drejtuesi i njësisë kryesore. Lista i përcillet Rektoratit për njoftim.
12. Aplikantët kanë të drejtën e ankimit, brenda 3 (tre) ditëve pune nga shpallja e listës paraprake të kandidatëve. Ankimi bëhet pranë zyrës së protokollit të njësisë kryesore dhe i përcillet menjëherë komisionit ad hoc përkatës. Komisionet ad hoc brenda 2 (dy) ditëve pune shqyrtojnë ankimet dhe marrin vendim mbi shqyrtimin e ankimit. Vendimi i përcillet menjëherë dekanit, i cili vendos në dispozicion të ankuesit një kopje të tij.
13. Pas përfundimit të procesit të ankimimit, Komisioni *ad hoc* vendos përfundimisht udhëheqësit shkencorë sipas renditjes së kandidatëve dhe propozimeve të kërkimit shkencor. Nëse e vlerëson, në këtë mbledhje Komisioni mund të ftojë edhe kandidatët fitues të programit.
14. Lista e kandidatëve fitues, e udhëheqësve shkencorë përkatës dhe projekteve kërkimore fituese përcillet tek drejtuesi i njësisë kryesore, shoqëruar me një relacion shpjegues për punën e kryer, sipas çdo fushe/nënfushe.
15. Drejtuesi i njësisë kryesore shqyrton dokumentacionin dhe procedurat e kryera dhe pas miratimit e përcjell praktikën e plotë në Rektoratin e UMT-së. Pas miratimit nga Rektori i UMT-së, lista e kandidatëve fitues, e udhëheqësve shkencorë përkatës dhe projekteve kërkimore fituese përcillet për publikim tek drejtuesi i njësisë kryesore.
16. Drejtuesi i njësisë kryesore brenda 3 (tre) ditëve pune publikon listën e kandidatëve fitues (*e anonimizuar me ID përkatëse*).
17. Rektorati i UMT-së gëzon të drejtën e monitorimit të procesit të aplikimit dhe shpalljes së fituesve në këto programe studimi.
18. Brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga publikimi i listës përfundimtare kryhet regjistrimi i kandidatëve fitues pranë sekretarisë përkatëse, si dhe bëhet nënshkrimi i kontratës midis kandidatit fitues dhe përgjegjësit të programeve të studimit të doktoratës në nivel njësie kryesore, bashkëlidhur këtij Udhëzimi.
19. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga regjistrimi i kandidatëve fitues, UMT-ja përcjell në QSHA listën e doktorantëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike, me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, në zbatim të udhëzimit përkatës të ministrisë përgjegjëse për arsimin.
20. Në varësi të projektit kërkimor, kandidatët fitues të programit duhet të kërkojnë miratim nga Këshillit i Etikës të UMT-së për projektin e tyre kërkimor.

IV. Dispozita të fundit

1. Njësitë kryesore të UMT-së të shpallin hapjen e procesit të aplikimeve për programin e studimeve të ciklit të tretë të doktoratës në datën 20 mars 2025.
2. Për të gjitha çështjet të cilat nuk trajtohen në këtë Udhëzim, do të zbatohen përcaktimet ligjore të Rregullores “*Për organizimin e programeve të studimit të doktoratave*”, e ndryshuar.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe Drejtoria e Kërkimit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit dhe Drejtoria e Administrimit Akademik dhe Kurrikulës në Rektoratin e UMT-së.
4. Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
PROF. DR. XHELADIN DRAÇINI



Deklaratë nr. 1

Data __. __. 2025

DEKLARATË

Unë i/e nënshkruari/a _____, aplikant/e në programin e studimit të doktoratës në fushën/nënfushën _____, të Fakultetit _____, të UMT-së, deklaroj nën përgjegjësinë time personale se, shprehem dakord të paguaj detyrimet financiare në programin e studimeve të doktoratës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për këtë program studimi.

Kjo deklaratë nënshkruhet me vullnet të plotë e të lirë.

DEKLARUES/E

(emër atësi mbiemër)

Data __. __. 2025

DEKLARATË

Unë i nënshkruari _____, me nr personal identifikimi (ID) _____, deklaroj nën përgjegjësinë time personale se, nuk kam kryer shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës.

Gjithashtu, deklaroj se, do të zbatoj standardet shkencore dhe etike gjatë kërkimit shkencor në programin e studimit të doktoratës.

Kjo deklaratë nënshkruhet me vullnet të plotë e të lirë.

DEKLARUES

(emër atësi mbiemër)

Deklaratë nr. 3

Data __. __. 2025


DEKLARATË

Unë i nënshkruari _____, me nr. personal identifikimi (ID) _____, deklaroj nën përgjegjësinë time personale se, nuk jam duke ndjekur ndonjë program tjetër studimi.

Kjo deklaratë nënshkruhet me vullnet të plotë e të lirë.

DEKLARUES

(emër atësi mbiemër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR ARSIMIN DHE SPORTIN

DREJTORIA E LEJEVE, LICENCAVE DHE MONITORIMIT TË SHËRBIMEVE

Nr. 8057/1 Prot.

Tiranë, më 22.01.2025

Lënda: Mbi listën e udhëheqësve në programet e studimit të ciklit të tretë në Doktoratë, për vitin akademik 2024-2025

UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

Adresa: "Rruga e Dibrës", Nr. 371, 1005

Për dijëni:

QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr. 23, Tiranë

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë

Në vijim të shkresës tuaj, nr. 1543 prot., datë 28.05.2024, regjistruar në MAS me nr. 3494 prot., datë 29.05.2024, me anë të së cilës është dërguar Vendimi nr. 83, datë 24.05.2024 i Senatit Akademik "Për miratimin e kuotave të pranimit për programet e ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë", për vitin akademik 2024-2025, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", si dhe referuar dokumentacionit të dërguar me shkresën nr. 1543/8 datë 12.09.2024 regjistruar me nr. 3494/2 datë 16.09.2024 në MAS dhe në pëgjigje të shkresës tuaj, nr. 3366 prot., datë 23.12.2024, regjistruar në MAS me nr. 8057 prot., datë 24.12.2024, me anë të të cilës është dërguar Vendimi nr. 139, datë 13.12.2024 i Senatit Akademik "Për miratimin e kuotave të pranimit për programet e përbashkëta të ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë" me Universitetin e Bolonjës, Itali, për vitin akademik 2024-2025, ju bëjmë me dije se:

MAS konfirmon listën e personelit akademik të kategorisë "Profesor", të propozuar nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2024-2025, sipas tabelës së mëposhtme ku pasqyrohen udhëheqësit dhe numrat e udhëheqjeve për vitin akademik 2024-2025:

Nr.	Njësia Kryesore	Udhëheqësit shkencor sipas programit të studimit	Nr. i udhëheqjeve të konfirmuara për vitin akademik 2023-2024 (shkresat nr. 1167/3 prot., datë 08.09.2023 dhe nr. 1167/6 prot., datë 04.12.2023)	Nr. i udhëheqjeve faktike për vitin akademik 2023-2024	Nr. i udhëheqjeve për vitin akademik 2024-2025
I	Fakulteti i Mjekësisë	Shëndet Publik	11	11	12
1		Prof. Gentiana Qirjako	1	1	1
2		Prof. Enver Roshi	1	1	1
3		Prof. Elizana Petrela	1	1	1
4		Prof. Gene Burazeri	1	1	1
5		Prof. Alban Ylli	1	1	1
6		Prof. Asoc. Jolanda Hyska	1	1	1
7		Prof. Asoc. Adrian Hoxha	1	1	1
8		Prof. Asoc. Adriatik Gabrani	1	1	1
9		Prof. Asoc. Loreta Kuneshka	1	1	1
10		Prof. Asoc. Ervin Toci	1	1	1
11		Prof. Asoc. Qamil Dika	1	1	1
12		Prof. Asoc. Eugena Tomini	-	-	1
II	Fakulteti i Mjekësisë	Farmaci	21	9	10
1		Prof. Ledjan Malaj	3	1	1
2		Prof. Suela Këlliçi	3	1	1
3		Prof. Vilma Papajani	3	1	1
4		Prof. Asoc. Mirela Miraci	2	1	1
5		Prof. Asoc. Ela Hoti (Malaj)	2	1	1
6		Prof. Asoc. Brunilda Myftari	2	1	1
7		Prof. Asoc. Entela Haloci	2	1	1
8		Prof. Asoc. Kejda Harasanaj	2	1	1
9		Prof. Asoc. Erjon Troja	2	1	1
10		Prof. Asoc. Iris Hoxha	-	-	1
III	Fakulteti i Mjekësisë	Obstetrikë dhe Gjinekologji	8	7	6
1		Prof. Orion Gliozheni	1	1	1
2		Prof. Rubena Moisiu	2	2	1
3		Prof. Astrit Bimbashi	2	2	1
4		Prof. Asoc. Mirela Rista (Mino)	2	1	1

5		Prof. Eljona Demaliaj	1	1	1
6		Prof. Asoc. Enkelejda Prifti	-	-	1
IV	Fakulteti i Mjekësisë	Radiologji	4	4	6
1		Prof. Liri Cuko	2	2	-
2		Prof. Asoc. Durim Cela	2	2	-
3		Prof. Asoc. Arben Rroji (k.pjesshme)	-	-	1
4		Prof. Asoc. Eugen Enesi (k.pjesshme)	-	-	1
5		Prof. Asoc. Fatmir Bilaj (k.pjesshme)	-	-	1
6		Prof. Asoc. Ilirjan Laçi (k.pjesshme)	-	-	1
7		Prof. Asoc. Maksim Basho (k.pjesshme)	-	-	1
8		Prof. Asoc. Sandër Kola (k.pjesshme)	-	-	1
V	Fakulteti i Mjekësisë	Anatomi	6	6	14
1		Prof. Xheladin Ceka	1	1	2
2		Prof. Vera Ostreni	1	1	1
3		Prof. Asoc. Majlinda Kokici	1	1	1
4		Prof. Asoc. Arben Mitrushi	1	1	1
5		Prof. Asoc. Nikollaq Leka	1	1	1
6		Prof. Asoc. Anila Kristo	1	1	1
7		Prof. Asoc. Marsida Duli	-	-	2
8		Prof. Asoc. Andi Kaçani	-	-	1
9		Prof. Asoc. Ermal Likaj	-	-	2
10		Prof. Asoc. Gëzim Xhepa	-	-	2
VI	Fakulteti i Mjekësisë	Fiziologji	11	11	11
1		Prof. Gentian Vyshka	2	2	-
2		Prof. Bledar Kraja	2	2	1
3		Prof. Leonard Deda	1	1	1
4		Prof. Asoc. Albana Fico	1	1	1
5		Prof. Monika Belba	1	1	1
6		Prof. Asoc. Edi Grabocka	1	1	1
7		Prof. Asoc. Laerta Kakariqi	1	1	1
8		Prof. Asoc. Iris Mone	1	1	1
9		Prof. Asoc. Edlira Rruçi	1	1	1
10		Prof. Asoc. Anxhela Gurakuqi (Qirko)	-	-	1

11		Prof. Asoc. Albert Brahim (k.pjesshme)	-	-	1
12		Prof. Asoc. Selman Dumani (k.pjesshme)	-	-	1
VII	Fakulteti i Mjekësisë	Pediatri	11	10	18
1		Prof. Elmira Kola	2	1	2
2		Prof. Asoc. Alketa Hoxha (Qosja)	2	2	-
3		Prof. Asoc. Dritan Alushani	2	2	-
4		Prof. Numila Kuneshka	2	1	2
5		Prof. Diamant Shtiza	1	1	1
6		Prof. Asoc. Ilirjana Bakalli (Klironomi)	1	1	1
7		Prof. Donjeta Bali (Aliaj)	1	1	1
8		Prof. Anila Godo	-	-	1
9		Prof. Paskal Cullufe	-	-	2
10		Prof. Raida Petrela	-	-	1
11		Prof. Anila Babameto	-	-	1
12		Prof. Asoc Manika Kreka	-	-	1
13		Prof. Asoc. Sokol Buba	-	-	1
14		Prof. Asoc. Saimir Heta (k.pjesshme)	-	-	2
15		Prof. Gjeorgjina Kuli (Lito)	-	1	2
VIII	Fakulteti i Mjekësisë	Oftalmologji	10	10	1
1		Prof. Asoc. Vilma Mema	2	2	-
2		Prof. Pajtim Lutaj	2	2	1
3		Prof. Asoc. Arjeta Grezda	2	2	-
4		Prof. Asoc. Ali Tonuzi	2	2	-
5		Prof. Asoc. Ilir Arapi	2	2	-
IX	Fakulteti i Mjekësisë	Neurologji dhe Neurokirurgji	12	10	9
1		Prof. Ariel Como	1	-	-
2		Prof. Jera Kruja	2	2	1
3		Prof. Asoc. Artur Xhumari	2	2	1
4		Prof. Arsen Seferi	1	1	1
5		Prof. Ridvan Alimehmeti	1	1	1
6		Prof. Suzana Gjeci	1	1	-
7		Prof. Mentor Petrela	1	1	1
8		Prof. Mira Rakacolli	1	1	1
9		Prof. Asoc. Sokrat Xhaxho	1	-	-
10		Prof. Asoc. Altin Kuço	1	1	1

11		Prof. Ilirjana Zekja			1
12		Prof. Asoc. Arben Rroji (k.pjesshme)	-	-	1
X	Fakulteti i Mjekësisë	Psikiatri dhe Shëndet Mendor	10	7	9
1		Prof. Ariel Como	2	2	1
2		Prof. Jera Kruja	1	-	-
3		Prof. Gentian Vyshka	1	1	-
4		Prof. Asoc. Fatime Elezi	2	1	1
5		Prof. Asoc. Valbona Alikaj	2	2	-
6		Prof. Suzana Gjeci	2	1	1
7		Prof. Vuksan Kola	-	-	2
8		Prof. Vera Ostreni	-	-	1
9		Prof. Anita Pilika	-	-	2
10		Prof. Arben Lloja	-	-	1
XI	Fakulteti i Mjekësisë	Kirurgjisë, me nënfusha:			
		1. Kirurgji e përgjithshme dhe nënspecialitete	23	23	31
		Prof. Etmont Çeliku	2	2	1
		Prof. Xheladin Draçini	2	2	1
		Prof. Arvin Dibra	1	1	1
		Prof. Arben Gjata	2	2	-
		Prof. Arben Beqiri	1	1	2
		Prof. Asoc. Enton Bollano	1	1	1
		Prof. Hektor Sula	2	2	-
		Prof. Asoc. Alma Cani	1	1	1
		Prof. Krenar Lilaj	2	2	-
		Prof. Asoc. Majlinda Naço	1	1	1
		Prof. Edmond Zaimi	1	1	1
		Prof. Asoc. Silvana Celiku	1	1	1
		Prof. Helidon Nina	1	1	1
		Prof. Gjergj Caushi	1	1	1
		Prof. Asoc. Vilson Ruci	1	1	1
		Prof. Gjergji Belba	1	1	1
		Prof. Asoc. Myzafer Kaçi	1	1	1
		Prof. Asoc. Henri Kolani	1	1	-
	Prof. Rudin Domi	-	-	2	
	Prof. Agron Dogjani	-	-	1	

		Prof. Asoc. Daniel Tereska	-	-	1
		Prof. Asoc. Edvin Selmani	-	-	1
		Prof. Asoc. Saimir Kuci	-	-	2
		Prof. Fadil Gradica	-	-	2
		Prof. Asoc. Arben Zenelaj (k.pjesshme)	-	-	1
		Prof. Asoc. Rovena Bode (k.pjesshme)	-	-	1
		Prof. Asoc. Fatmir Caushi	-	-	2
		Prof. Asoc. Vladimir Filaj	-	-	2
		Prof. Asoc. Filadelfo Coniglione (k.pjesshme)	-	-	1
		2. Otorinolaringologji	5	5	1
		Prof. Asoc. Besim Boci	2	2	-
		Prof. Brikena Qirjazi	3	3	-
		Prof. Suela Sallavaci (k.pjesshme)	-	-	1
XII	Fakulteti i Mjekësisë	Mjekësisë Interne, me nënfusha:			
		1. Mjekësi Interne	3	3	2
		Prof. Mihal Tase	1	1	-
		Prof. Margarita Resuli (Gjata)	1	1	2
		Prof. Asoc. Ergita Nelaj	1	1	-
		2. Gastroenterologji/Hepatologji	6	5	5
		Prof. Adriana Babameto	1	1	2
		Prof. Skerdi Prifti	2	2	1
		Prof. Ilir Bibolli	1	1	-
		Prof. Jovan Basho	1	1	1
		Prof. Edite Sadiku	1	-	1
		3. Endokrinologji/Diabetologji	5	5	3
		Prof. Agron Ylli	2	2	1
		Prof. Florian Toti	1	1	2
		Prof. Asoc. Dorina Ylli	2	2	-
		4. Pneumologji	7	5	1
		Prof. Silvana Bala	2	2	1
		Prof. Hasan Hafizi	2	2	-
		Prof. Perlat Kapisyzi	3	1	-
		5. Hematologji	3	2	2
		Prof. Arben Ivanaj	2	2	1
		Prof. Tatjana Caja	1	-	1
		6. Mjekësi Laboratorike	5	4	9
	Prof. Anyla Buló	1	1	-	

Prof. Etleva Refatllari	1	1	-
Prof. Andi Koraqi	1	1	1
Prof. Linda Fuga	1	-	1
Prof. Asoc. Irena Qendro (Seferi)	1	1	1
Prof. Asoc. Nevila Alliu (Heta)	-	-	2
Prof. Asoc. Teuta Kurti	-	-	2
Prof. Asoc. Gentian Kasmi	-	-	2
7. Alergologji	2	2	3
Prof. Etleva Qirko	1	1	2
Prof. Asoc. Mehmet Hoxha	1	1	1
8. Nefrologji Dializë Transplant	5	5	2
Prof. Myftar Barbullushi	0	0	0
Prof. Alma Idrizi	2	2	1
Prof. Asoc. Ariana Strakosha	2	2	-
Prof. Asoc. Merita Rroji	1	1	1
9. Reumatologji	2	2	1
Prof. Teuta Backa	2	2	1
10. Studime të thelluara në Kardiologji	11	11	9
Prof. Alban Dibra	2	2	1
Prof. Artan Goda	1	1	-
Prof. Mimoza Lezha	2	2	1
Prof. Sokol Myftiu	1	1	-
Prof. Arben Baboci	1	1	-
Prof. Asoc. Altin Veshti	1	1	1
Prof. Sokol Xhepa	1	1	2
Prof. Edmond Nuellari	1	1	1
Prof. Asoc. Andi Kaçani	1	1	-
Prof. Edvin Prifti	-	-	1
Prof. Asoc. Leonard Simoni (k.pjesshme)	-	-	2
11. Mjekësi Familje	3	3	3
Prof. Llukan Rrumbullaku	1	1	1
Prof. Polikron Pulluqi	1	1	1
Prof. Asoc. Ilir Alimehmeti	1	1	1
12. Sëmundje Infektive	6	6	4
Prof. Arjan Harxhi	2	2	-
Prof. Najada Como	1	1	1
Prof. Pellumb Pipero	1	1	1
Prof. Silva Bino	1	1	1

		Prof. Asoc. Entela Ramosaco (Kolovani)	1	1	1
		13. Dermatologji Venerologji	5	5	0
		Prof. Ermira Vasili	3	3	-
		Prof. Asoc. Monika Fida	2	2	-
		Total Fakulteti i Mjekësisë	194	171	172
I	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	Mjekësisë Dentare me nënfusha:			
		1. Shkenca dentare	7	7	2
1		Prof. Adem Alushi	3	3	-
2		Prof. Asoc. Dorjan Hysi	2	2	-
3		Prof. Asoc. Etleva Droboniku	2	2	-
4		Prof. Asoc. Enida Petro	-	-	2
		2. Teknologji dentare dhe Ortodonci	7	7	5
1		Prof. Vergjini Mulo	3	3	-
2		Prof. Edit Xhajanka	2	2	1
3		Prof. Asoc. Çeljana Toti	2	2	-
4		Prof. Asoc. Alketa Qafmolla	-	-	2
5		Prof. Asoc. Rosela Xhemnica	-	-	2
		3. Kirurgji Oro-Maksillofaciale	5	5	2
1		Prof. Ramazan Isufi	3	3	-
2		Prof. Asoc. Merita Bardhoshi	2	2	-
3		Prof. Asoc. Silvana Bara	-	-	2
		Total Fakulteti i Mjekësisë Dentare	19	19	9
I	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Shkenca Mjekësore Teknike me nënfusha:			
		1. Teknologji Mjekësore diagnostikuese dhe trajtuese	4	4	4
1		Prof. Asoc. Admir Nake	1	1	-
2		Prof. Asoc. Albana Gjzari	2	2	-
3		Prof. Asoc. Gentjan Stroni	1	1	1
4		Prof. Floreta Kurti	-	-	1
5		Prof. Asoc. Klodiana Poshi	-	-	1
6		Prof. Asoc. Nejla Bajrami	-	-	1
		2. Infermieri dhe Mami	4	4	10
1		Prof. Asoc. Ergys Ramosaçaj	1	1	1
2		Prof. Asoc. Elinda Gjata	2	2	-

3		Prof. Ilirjana Zekja	1	1	-
4		Prof. Asoc. Alma Barbullushi	-	-	1
5		Prof. Asoc. Etleva Rustami	-	-	1
6		Prof. Asoc. Yllka Themeli	-	-	1
7		Prof. Asoc. Valbona Bilali	-	-	1
8		Prof. Asoc. Rudina Pirushi	-	-	1
9		Prof. Asoc. Zamira Imeraj	-	-	1
10		Prof. Asoc. Enkelejda Shkurti	-	-	1
11		Prof. Gjergj Belba	-	-	1
12		Prof. Asoc. Ledi Naçaj	-	-	1
1		3. Fizioterapi dhe Rehabilitim	4	4	5
2		Prof. Asoc. Enkelelda Sinaj	2	2	-
3		Prof. Ilirjana Zekja	1	1	-
4		Prof. Manika Kreka (Face)	1	1	-
5		Prof. Asoc. Alma Nurçe	-	-	1
6		Prof. Irena Kola	-	-	1
7		Prof. Asoc. Vjollca Ndreu	-	-	1
8		Prof. Asoc. Mustafa Bajraktari	-	-	1
9		Prof. Ermira Ziçishti Petraj (shtyrje pensioni)	-	-	1
		Total Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	12	12	19
		Total UMT	225	202	200
Doktorata të përbashkëta me Universitetin e Bolonjës, Itali					
Nr.	Njësia kryesore	Udhëheqësit shkencor sipas programit të studimit	Nr. i udhëheqjeve të konfirmuara nga MAS (2023-2024)	Nr. i udhëheqjeve faktike për vitin akademik 2023-2024	Nr. i udhëheqjeve për vitin akademik 2024-2025
I	Fakulteti i Mjekësisë	Mjekësi Interne	2	-	1
		Prof. Margarita Gjata	2	-	-
		Prof. Asoc Valbona Hoxha (Duraj)			1
II	Fakulteti i Mjekësisë	Kirurgji	2	2	1
		Prof. Arben Gjata	1	1	-
		Prof. Arvin Dibra	1	1	-
		Prof. Asoc Dariel Thereska			1

III	Fakulteti i Mjekësisë	Obstetrikë dhe Gjinekologji	1	-	1
		Prof. Orion Gliozheni	1	-	-
		Prof. Eliona Demaliaj			1
		Total programe të përbashkëta	5	2	3

Në vijim të zhvillimit të studimeve, në rast se do të ketë ndryshime të personelit akademik nga lista bashkëlidhur, për arsye objektive, këto ndryshime të paraqiten në MAS për miratim, së bashku me dokumentacionin përkatës (dëshmitë e titujve akademikë, kontratat e punës, letërangazhimin e personelit akademik si drejtues shkencor për udhëheqjen e doktorantëve në këtë program studimi, aktin e dorëheqjes nga udhëheqja, apo çdo akt tjetër që sjell ndryshimin e udhëheqësve). Në rastin e ndryshimit të udhëheqësit gjatë studimeve të doktoratës, udhëheqësi shkencor që ka drejtuar veprimtarinë për fitimin e gradës shkencore prej doktorantit, konsiderohet ai që ka miratuar tezën e disertacionit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,


SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I -----



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

LOGO E FAKULTETIT

Nr. _____ prot.

Tiranë më, ____ . ____ . ____

KONTRATË DOKTORALE

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenet 77, 78 dhe 79; VKM nr. 112, datë 23.02.2018, “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar, Kreu I; VKM nr. 777, datë 26.12.2018, “Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”, i ndryshuar; VKM nr. 75, datë 12.02.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”; Udhëzimin e MAS nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar; Udhëzimin e MAS nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, Statutin e UMT-së, nenet 88 dhe 89, si dhe Rregulloren “Për organizimin e programeve të studimit të doktoratave”, e ndryshuar, sot më datë ____ . ____ . ____ lidhet kjo kontratë me kushtet e mëposhtme:

NENI 1 - PALËT

Palët në këtë kontratë janë:

1. Ofruesi i programit të studimit të doktoratës: Fakulteti i _____,
Departamenti i _____, i përfaqësuar në këtë kontratë nga Përgjegjësi i
Programeve të Studimit të Doktoratës, **Emër Mbiemër.**

dhe

2. Emër, Atësi, Mbiemër, lindur më _____, student në programin e studimit të doktoratës pranë Departamentit të _____, shpallur fitues me Vendimin nr.____, datë____.____, të Dekanit të Fakultetit të_____.

NENI 2 - OBJEKTI I KONTRATES

1. Objekti i nënshkrimit të kësaj kontrate, është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të palëve, nga pikëpamja akademike, kërkimore, financiare dhe administrative në projektin fitues të programit të studimit të doktoratës si më poshtë:

1.1. Projekti Kërkimor

1.2. Titulli i Disertacionit

1.3. Udhëheqësi

(emër, mbiemër (titulli akademik), departamenti, fakulteti, universiteti)

2. Palët shprehin vullnetin të respektojnë rregullat e parashikuara në këtë kontratë, kuadrin ligjor sektorial në fuqi, si edhe praktikatat e mira zakonore të kërkimit shkencor.

NENI 3 - STRUKTURAT PËRGJEGJËSE

1. Njësitë bazë të njësive kryesore të UMT-së, janë përgjegjëse për organizimin dhe drejtimin e programeve të studimit të doktoratës.
2. Nëse programi i studimit ofrohet nga më shumë se një njësi bazë, organizimi dhe drejtimi i programeve të studimit të doktoratës, përcaktohen në bashkëpunim të njësive bazë me njëra-tjetrën sipas marrëveshjeve të hartuara prej tyre. Në rast të programeve që përfshijnë më shumë se një njësi bazë, njëra prej njësive bazë caktohet si përgjegjëse për ofrimin e programit të kërkimit të kandidatit, në dakordësi midis tyre. Njësitë bazë mund të mbështeten edhe nga qendrat kërkimore-shkencore të njësisë kryesore për realizimin e programit të doktoratës.
3. Përgjegjësi i programeve të studimit të doktoratës në nivel njësie kryesore, është Zëvendësdekani për kërkimin shkencor, i cili drejton programin në bashkëpunim me Koordinatorët përkatës të programeve të studimit të doktoratës në njësitë bazë.

4. Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” është përgjegjës për vlerësimin e dosjes së doktorantit, ngritjen e jurisë dhe marrjen e vendimit për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.
5. Vlerësimi i disertacionit të kandidatit për gradën shkencore “Doktor” realizohet nga Juria e posaçme, e ngritur për këtë qëllim.

NENI 4 - TË DREJTAT DHE DETYRIMET E STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE TË PROGRAMIT

4.1 Përgjegjësitë e udhëheqësit shkencor

1. Të garantojë se do të zbatojë të gjitha rregullat shkencore dhe etike gjatë udhëheqjes së doktoratës.
2. Të angazhohet që udhëheqja të kryhet brenda kohës së parashikuar.
3. Të japë mbështetjen e duhur akademike dhe këshillimin e nevojshëm që t’i mundësojë kandidatit të arrijë standarde të larta të kërkimit. Kjo përfshin ndihmën:
 - a) Për formulimin e titullit të punimit, për përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit.
 - b) Rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit.
 - c) Këshillimin për organizimin e shënimeve dhe përgatitjen e punimit.
 - d) Ndjekjen e zbatimit dhe përfundimit të studimit sipas protokollit të miratuar.
4. Udhëheqësi ka përgjegjësi t’i bëjë të ditur studentit rrezikun e falsifikimeve dhe të plagjiaturës.
5. Në rastet e bashkëudhëheqjes, përgjegjësitë duhet të jenë të qarta për të dyja palët dhe ato duhet të mbajnë kontakte të rregullta.
6. Të vlerësojë progresin e studentit rregullisht (takime të rregullta) duke i kërkuar atij të paraqesë një raport të shkruar dhe të monitorojë punën e tij përkundrejt standardit të kërkuar.
7. T’i bëjë të ditur studentit nëse puna e tij është në standardin e kërkuar dhe të ndërmarrë veprimet e duhura mbështetëse.
8. Të ndihmojë studentin në përgatitjen e punës së tij që do të prezantohet në aktivitete shkencore brenda ose jashtë vendit.
9. Të vërtetojë se kandidati ka plotësuar të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet e jurisë kur ajo e ka rikthyer punimin për riparaqitje.
10. Të nxisë studentin që ai të botojë pjesë nga kërkimi i tij.
11. Udhëheqësi duhet të vlerësojë të gjitha dorëshkrimet e paraqitura nga kandidati bazuar në kriteret e mëposhtme:
 - a) Rëndësia e temës që është marrë në studim;
 - b) Formulimi dhe qartësia e kërkimit shkencor;
 - c) Origjinaliteti i diskutimit shkencor;
 - d) Niveli shkencor i strukturimit, analizës dhe përpunimit të të dhënave shkencore;
 - e) Saktësia dhe qartësia metodologjike e këtyre analizave;
 - f) Përfundimet dhe konceptet e reja;
 - g) Ballafaqimet kritike ndërmjet konkluzioneve të kandidatit, teorive dhe koncepteve ekzistuese.

- h) Krijimtarinë e kandidatit në fushën e studimit që mbulon teza.
- i) Kufizimet e studimit të paraqitura në tekst nga kandidati.
- j) Strukturën e balancuar dhe të qartë të pjesëve të tezës së doktoratës.

4.2 Përgjegjësitë e njësisë bazë

1. Njësia bazë është struktura përgjegjëse për zhvillimin e punës për kërkimin shkencor, për hapjen dhe riorganizimin e programit të doktoratës dhe ndjekjen e të gjitha fazave të procesit të doktoratës.
2. Njësia bazë përcakton dhe miraton fushat/ nënfushat e kërkimit shkencor, ku do të zhvillohen projektet e doktoratës.
3. Njësia bazë përcakton kuotat dhe kriteret për pranimin e studenteve doktorantë, shqyrton dhe miraton listën e kandidatëve fitues në programin e saj të doktoratës.
4. Njësia bazë miraton udhëheqësit e punimeve të doktoratës.
5. Njësia bazë ka përgjegjësi t'iu sigurojë studentëve doktorantë lehtësitë e nevojshme administrative për marrjen e informacionit dhe të literaturës së nevojshme kërkimore-shkencore pranë institucioneve publike dhe private.
6. Njësia bazë ka përgjegjësi të garantojë përmbushjen e kriterëve formale dhe ato të antiplagjiaturës nga kandidatët, përpara shqyrtimit të dosjes së tyre nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor".
7. Njësia bazë ka përgjegjësi të shqyrtojë raportet e ecurisë së kërkimit shkencor, të paraqitura nga studentët dhe udhëheqësit dhe të garantojë se udhëheqësit kanë kontakt të rregullt me studentët. Në rastet kur konstaton probleme, propozon ndryshimet e nevojshme.
8. Njësia bazë ka përgjegjësi të informojë studentët e pranuar në programin e saj të doktoratës për aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, përfshirë edhe këtë rregullore, që lidhen me procesin e fitimit të gradës shkencore.
9. Në kushtet e kërkesës për ndryshimin e temës së disertacionit, doktoranti paraqet një raport drejtuar Përgjegjësit të Njësisë bazë, të nënshkruar prej tij dhe udhëheqësit, ku të argumentohet ndryshimi i temës. Drejtuesi i Njësisë bazë, vendos për miratimin ose jo të ndryshimit të temës së disertacionit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dorëzimi i kërkesës. Ndryshimi i temës së disertacionit është i mundur vetëm 1 (një) herë dhe vetëm gjatë vitit të parë të programit të studimit. Në këtë rast, kohëzgjatja e programit të studimit, rifillon nga data e vendimit për miratimin e ndryshimit të temës së disertacionit.

4.3 Detyrat e përgjegjësit të programeve të studimeve të doktoratës

Programet e doktoratës në nivel të njësisë kryesore ndiqen/drejtohen nga përgjegjësi i programeve të studimit të doktoratës, që është Zëvendësdekani për kërkimin shkencor, i cili ka përgjegjësi:

1. Të mbikëqyrë dhe të sigurojë që njësia bazë respektojnë, në ushtrimin e përgjegjësisë së tyre në lidhje me programet e studimit të doktoratës, kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, këtë rregullore, në drejtim të:
 - a) respektimit të afateve dhe të kriterëve për shpalljen e hapjes së programit të doktoratës;

- b) respektimit të rregullave në lidhje me përzgjedhjen e kandidatëve fitues;
 - c) respektimit të kriterëve në lidhje me udhëheqësit shkencorë, përfshirë, por jo vetëm, kriteret në lidhje me titullin akademik, që duhet të ketë udhëheqësi (“Profesor” ose “Profesor i Asociuar”), numrin maksimal të doktorantëve që mund të udhëheqë, ekspertizën në fushën specifike të kërkimit si edhe mundësitë reale në ofrimin e një udhëheqjeje cilësore për kandidatët;
 - d) respektimit të procedurave të udhëheqjes dhe shqyrtimit të ecurisë së kërkimit shkencor.
2. Të mbikëqyrë dhe të sigurojë që studentët e doktoratës të informohen për të gjitha aktet ligjore, nënligjore, udhëzime dhe rregullore, që kanë të bëjnë me procesin e fitimit të gradës shkencore “Doktor”.

4.4 Përgjegjësitë e Koordinatorit Shkencor të Programit të Studimit të Doktoratës

1. Të hartojë çdo vit një listë me temat që janë në studim.
2. Të kujdeset që të gjithë studentët të kenë udhëheqës shkencorë. Të respektojë rregullat për caktimin e udhëheqësit shkencor të doktoratës.
3. Të garantojë se udhëheqësit e propozuar janë ekspertë të fushës së kërkimit, kanë kualifikimet e kërkuara, kohën dhe angazhimin për t’i ofruar kandidatit një udhëheqje cilësore të kërkimit dhe një menaxhim cilësor të punës së tij.
4. Të garantojë se udhëheqësit e temave nuk janë të mbingarkuar me udhëheqje diplomash.
5. Të garantojë se kandidatët i plotësojnë standardet për të punuar temën.
6. Të interesohet për t’u siguruar kandidatëve lehtësirat e nevojshme.
7. Të garantojë se janë respektuar politikat e udhëheqjes.
8. Të garantojë se për zhvillimin e doktoratës zbatohen standardet e kërkimeve shkencore.
9. Të shqyrtojë raportet e progresit të kërkimit të paraqitura nga studentët dhe udhëheqësit dhe të garantojë se udhëheqësi/t ka kontakt të rregullt me studentët. Në rastet kur konstaton probleme, i propozon njësisë bazë ndryshimet e nevojshme.
10. Të garantojë se procedura e mbikëqyrjes dhe e shqyrtimit të ecurisë së kërkimit është e rregullt.
11. T’i njohë studentët me të gjitha aktet ligjore, nënligjore, udhëzime, rregullore etj, që kanë të bëjnë me procesin e fitimit të gradës shkencore.
12. Koordinatorin së bashku me Administratorin e Fakultetit të ndjekë realizimin e pagesave periodike për udhëheqësit shkencorë.

4.5 Përgjegjësitë e Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”

1. Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” është Komision i përhershëm që ngrihet në nivel njësie kryesore. Ai është përgjegjës për monitorimin e procesit të dhënies së gradës shkencore “Doktor”.
2. Përbërja dhe mënyra e krijimit dhe e funksionimit të këtij komisionit përcaktohen në legjislacionin në fuqi dhe në rregulloren e vetë komisionit.

3. Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin e dosjes së Kandidatit dhe nëse vlerëson që dosja përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe përmbush kriteret e përcaktuara në këtë rregullore, ngre Jurinë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja në shqyrtim e dosjes.
4. Komisioni është organi kompetent për vendimmarrjen në lidhje me dhënien e gradës Shkencore “Doktor”, pas shqyrtimit të raportit të vlerësimit të Jurisë.

NENI 5 - PËRGJEGJËSITË E STUDENTIT TË DOKTORATËS

5.1 Studenti ka të drejtë:

- a) të kërkojë krijimin e kushteve për ndjekjen e veprimtarive të parashikuara në programin e studimeve;
- b) të marrë informacion mbi bazën ligjore dhe akte rregullatore në fushën e doktoratave;
- c) të shfrytëzojë bibliotekën e fakultetit apo të njësisë përkatëse të kërkimit;
- d) të shfrytëzojë burimet elektronike të informacionit pranë ambienteve të njësisë bazë/ kryesore;
- e) të aplikojë për të marrë pjesë në mobilitete/periudha kërkimi në institucionet me të cilat UMT ka marrëveshje, kur këto mobilitete i dedikohen studentëve të doktoratës;
- f) të tërhiqet vullnetarisht nga programi duke paraqitur kërkesën me shkrim.

5.2 Studenti ka për detyrë:

- a) të njohë rregulloren e programeve të studimit të doktoratës dhe bazën ligjore përkatëse (VKM, Udhëzime të MAS etj.)
- b) të plotësojë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga ligjet, vendimet, udhëzimet e rregulloret;
- c) të kompletojë programin e miratuar të kërkimit të doktoratës;
- d) të arrijë rezultate të larta në realizimin e programit të studimeve të doktoratës;
- e) t’i shlyejë në kohën e duhur universitetit (fakultetit), të gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga regjistrimi dhe vazhdimi i studimeve në programin e doktoratës;
- f) të raportojë, të paktën një herë në vit në njësinë bazë të programit (departament apo grup mësuesor shkencor) mbi ecurinë e punës për realizimin e programit;
- g) të zbatojë standardet shkencore dhe etike të parashikuara për doktoratën;
- h) të përfundojë punimin në kohën e duhur.

5.3 Gjatë periudhës së studimeve të doktoratës, përpara paraqitjes për mbrojtje, studenti duhet të ketë plotësuar kushtet e mëposhtme:

- a) Të ketë realizuar si autor i parë ose i dytë, kur autori i parë është udhëheqësi shkencor, së paku 3 (tre) referime, 2 (dy) nga të cilat të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “*Proceedings*”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN;
- b) të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore, nga të cilët 1 (një) të jetë botuar ose pranuar për botim në revista shkencore të rankuara në *Journal Citation Reports* ose *Scopus*, ku është, së paku, autor i dytë;
- c) të ketë përfunduar disertacionin, sipas formatit të përcaktuar në rregulloret përkatëse të

programit të studimit, i cili duhet të jetë në hartuar në zbatim të kuadrit ligjor dhe nënligjor, si edhe të akteve të miratuara nga UMT-ja, në lidhje me integritetin në kërkimin shkencor.

NENI 6 – AFATI I PËRFUNDIMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS

1. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se 3 (tre) vite akademike dhe jo më shumë se 5 (pesë) vite akademike. Afati i studimeve në programin e doktoratës fillon nga dita e nesërme e regjistrimit të kandidatit në program. Afati i mbrojtjes së tezës së doktoratës, nuk duhet të kalojë 5 vite nga regjistrimi në program.
2. Afati i përfundimit të studimeve të doktoratës pezullohet ose shtyhet me kërkesë të vetë kandidatit, kur ai nuk mund të vazhdojë rregullisht këtë program studimi për arsye objektive të përligjura (sëmundje të rënda, fatkeqësi, etj.), të cilat vlerësohen rast pas rasti. Në çdo rast, arsyet për të cilat kërkohet shtyrja/pezullimi duhet të jenë të dokumentuara. Kërkesa për shtyrje paraqitet kur studenti i doktoratës, konstaton se, nuk arrin të përmbyllë projektin e tij kërkimor brenda afatit të përcaktuar.
3. Periudha e pezullimit të afatit, nuk përlllogaritet në afatin maksimal të përcaktuar nga ligji, për përfundimin e programit të doktoratës. Në të dyja rastet, kërkesa për shtyrje/pezullim, duhet të jetë e miratuar nga udhëheqësi i doktoratës.
4. Njësia bazë përkatëse ngre një komision *ad hoc*, i përbërë nga 3 (tre) anëtarë personel akademik i kategorisë “Profesor”, për të shqyrtuar ekzistencën e kushteve për shtyrjen/pezullimin e programit të studimit, si edhe pasojat juridike apo financiare. Në vijim, përmes drejtuesit të njësisë bazë, komisioni *ad hoc* përcjell për miratim tek drejtuesi i njësisë kryesore, propozimin së bashku me dokumentacionin justifikues.
5. Vendimin për pezullim/shtyrje e merr dekani i njësisë kryesore.

NENI 7 - ETIKA NË PUNËN KËRKIMORE

1. Çdo disertacion duhet të reflektojë rregullat, që lidhen me etikën e punës kërkimore dhe integritetin akademik, në respektim të Etikës dhe Integritetit në kërkimin shkencor.
2. Kur dorëzon disertacionin kandidati duhet të deklarojë me shkrim se studimi është punë origjinale e tij.
3. Një kandidat nuk lejohet të paraqesë si punim, një punim që e ka paraqitur më parë në këtë njësi, por kandidati mund të paraqesë pjesë të punës nëse ai tregon qartë cila pjesë e punës është përdorur më parë.
4. Një kandidat mund të paraqesë një pjesë kontributi që është botuar më parë individualisht ose në grup. Nëse puna është pjesë e përpjekjeve të një-grupi, një shpjegim për pjesën e shkruar nga kandidati duhet të përfshihet në punim.
5. Plagjiatura përfshin përdorimin e ideve dhe fjalëve nga publikimet e një personi tjetër pa dhënë referencën përkatëse. Kërkohet që të shënohet referenca përkatëse nëse përdoren ide të tjerëve.
6. Përdorimi i ideve ose punës së të tjerëve duhet të evidentohet individualisht në tekst ose secili punim i përdorur duhet të shënohet në listën e referencave ose në bibliografi.

7. Kandidati mund të përfshijë në disertacion edhe pjesë nga studime individuale apo të realizuara me bashkautorë, ose të dhëna të përfituara nga kërkime në kuadër të projekteve kërkimore të tjera. Nëse kërkimi është realizuar në ekip, kandidati e evidenton këtë fakt dhe njeh kontributin e bashkëpunëtorëve.
8. Të gjitha citimet nga punimet e të tjerëve duhet të vendosen në thonjëza dhe të shënohet burimi.
9. Nëse pasazhet e marra nga të tjerët janë më të gjata se pesë radhë, nuk futen në thonjëza por shënohet referenca për to.
10. Sqarimet e mundshme të kandidatit duhen futur në kllapa katrore.
11. Nëse burimi origjinal nuk gjendet dot, por ai është përmendur në një dokument tjetër, atëherë duhet të jepen të dy komentet burimi origjinal dhe burimi dytësor.
12. Udhëheqësit duhet të sqarojnë që në fillim të punës se asnjë lloj mashtrimi, falsifikimi dhe plagjiature nuk do të tolerohet, por përkundrazi për to ka ndëshkime të ndryshme.
13. Në rastet kur pandershmëria akademike ka ndodhur, kjo i bëhet e ditur Dekanit për veprime të mëtejshme.
14. Pronësia intelektuale, e drejta e autorit për punimin (si edhe për një material të botuar), mbrohet nga ligji i së drejtës së autorit dhe akte të tjera ligjore të aplikueshme në këtë drejtim. Shënimi për rezervimin e të drejtës së autorit, simboli përkatës ©, emri i zotëruesit të autorësisë, viti i punimit duhet të vendosen në faqen që vjen pas titullit të punimit.

NENI 8 - RREGULLAT PËR PARAQITJEN E DISERTACIONIT

1. Disertacioni hartohet në gjuhën shqipe dhe një përmbledhje e tij (2000-4000 fjalë) hartohet në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian (*anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht*), në format të shtypur dhe elektronik. Përpara dorëzimit disertacioni miratohet nga udhëheqësi shkencor.
2. Përcaktimi i gjatësisë së punimit është jo më pak se, 80 (tetëdhjetë fletë) në projektet kërkimore të doktoratës në shkencat mjekësore teknike dhe jo më pak se, 120 (njëqind e njëzet fletë), në projektet kërkimore të doktoratës në shkencat mjekësore dhe të shëndetit.
3. Disertacioni duhet të plotësojë këto kërkesa të formatimit:
 - a) Lloji i shkrimit që duhet të përdoret në disertacion, është Times Neë Roman, masa e shkronjës duhet të jetë 12-she, formatimi *justify*, hapësirë ndërmjet rreshtave 1.15 (një pikë pesëmbëdhjetë), përveç rasteve kur në këtë Rregullore kërkohet ndryshe.
 - b) Margjinat për të gjithë tekstin do të jenë:

- Margjina e sipërme	1"
- Margjina e poshtme	1"
- Margjina e majtë	1.25"
- Margjina e djathtë	1.25"
 - c) Të gjitha numrat e faqeve duhet të vendosen poshtë dhe në mes të faqes.
 - d) Parathënia duhet të shtypet me shkronja kursive.
 - e) Hyrja duhet të ketë numra romakë.
 - f) Pjesa e studimit duhet të ketë numra arabë.

- g) Faqet e bibliografisë, shtojcave duhet të numërohen me numra arabë në vijim të numrit të faqeve të studimit.
- h) Shënimet në tekstin e disertacionit, bëhen në fund të faqes (*footnote*), me program kompjuterik.
- i) Tabelat e përfshira në tekst, duhet të vendosen në qendër të faqes, brenda margjinave të caktuara. Çdo tabelë i duhet vendosur një numër referimi me numër arab. Numërimi i tabelave në disertacion bëhet me numra të njëpasnjëshëm. Fjala “Tabelë”, numri i tabelës dhe legjenda, duhet të vendosen në krye të tabelës. Nëse tabela vazhdon në faqen tjetër legjenda nuk përsëritet. Nëse një tabelë përmban citate ose referime, ato duhet të vendosen në foot note. Si rregull, në shkrimin brenda tabelës, masa e shkronjës duhet të jetë 12-she dhe hapësirë ndërmjet rreshtave 1.15 (një pikë pesëmbëdhjetë), justify, përveç rasteve kur zbatimi i këtyre elementëve teknikë, ndikon në paraqitjen vizuale të tabelës.
- j) Diagramat, fotografitë, ilustrimet dhe grafikët, pasqyrohen në tekst me emërtimin “Figurë”. Çdo figure, i duhet vendosur një numër referimi me numër arab. Numërimi i figurave bëhet me numra të njëpasnjëshëm. Fjala “Figurë”, numri i saj dhe legjenda, vendosen poshtë. Nëse një figurë përmban citate ose referime, ato duhet të vendosen në foot note. Si rregull, në emërtimin e figurave, masa e shkronjës duhet të jetë 12-she dhe hapësira ndërmjet rreshtave 1.15 (një pikë pesëmbëdhjetë), justify, përveç rasteve kur zbatimi i këtyre elementëve teknikë, ndikon në paraqitjen vizuale të tyre. Përgjithësisht figurat, nuk duhet të kalojnë një faqe. Nëse ato vazhdojnë në faqen tjetër, duhet të ndiqet rregulli si për tabelat.
- k) Materialet shoqëruese - Nëse një punim përmban materiale shoqëruese të tilla, si: CD, disketa kompjuteri, video ose kasete etj. që janë një pjesë e rëndësishme e punimit, ato duhet t’i bashkëngjiten punimit.
- l) Shtypja - Materiali duhet të shtypet vetëm nga njëra anë e fletës. Të gjitha kopjet e disertacionit duhet të jenë të shtypura me kompjuter, të printuara qartë dhe të jenë të lexueshme lehtësisht. Nuk pranohen dorëshkrimet.
- m) Lloji i letrës - Duhet përdorur letër e cilësisë së lartë, e bardhë, format A4.
- n) Disertacioni në variantin e tij final, lidhet në pesë kopje origjinale.
- o) Në kapakun e përparmë të kopertinës të disertacionit, duhet të vendoset:
- Emri i universitetit (në krye, në mes të kopertinës);
 - Emri i njësisë kryesore (në krye, mes të kopertinës);
 - Emri i njësisë bazë, ku është zhvilluar programi i doktoratës (në krye, në mes të kopertinës);
 - Logo e universitetit (në krye, në anën e majtë të kopertinës);
 - Logo e njësisë kryesore (në krye, në anën e djathtë të kopertinës);
 - Fjala DISERTACION (në mes të kopertinës me germa kapitale, fonti i germës 20);
 - Emri i programit të doktoratës (në mes të kopertinës);
 - Emri i kandidatit (në fund, në anën e majtë të kopertinës);
 - Emri dhe grada e udhëheqësit (në fund, në anën e djathtë të kopertinës);
 - Qyteti dhe viti i mbrojtjes (në fund, në mes të kopertinës).
- p) Pjesa e pasme e kopertinës duhet të përmbajë:
- **Abstraktin në shqip dhe në anglisht.** Secili variant duhet të përmbajë 200 fjalë duke u përdorur masa 10–she e shkronjës. Ky element duhet t’u mundësojë lexuesve vendas dhe të

huaj të kuptojnë sesi është trajtuar çështja e marrë në studim. Abstrakti në anglisht është një kërkesë e standardeve ndërkombëtare.

- **Fushën dhe fjalët kyçe.** Studenti në bashkëpunim me udhëheqësin shkencor përcakton fushën dhe zgjedh fjalët kyçe në funksion të përshtatshmërisë së tyre me terminologjinë e përdorur në disipinën përkatëse. Ato ndihmojnë identifikimin e tezës midis katalogëve kolektive në biblioteka.

NENI 9 - ANULIMI I GRADËS SHKENCORE “DOKTOR”

1. Grada shkencore ”Doktor” mund të anulohet në rastet kur vërtetohet se, në veprimtarinë shkencore, që ka shërbyer për fitimin e gradës shkencore, konstatohen sjellje dhe praktika të papranueshme, në kundërshtim me parimet e etikës dhe integritetit në kërkimin shkencor, konkretisht:
 - a) Fabrikim – sajim i rezultateve dhe regjistrimi i tyre sikur të ishin të vërteta;
 - b) Falsifikim - manipulim i materialeve të kërkimit, pajisjeve apo proceseve ose ndryshimi, heqja apo shmangia e të dhënave apo rezultateve pa justifikim;
 - c) Plagjiaturë - përdorim i ideve dhe punës së të tjerëve pa ia njohur vlerën burimit origjinal, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtat e autorëve dhe produktet e tyre intelektuale.
2. Grada shkencore “Doktor”, mund të anulohet kur vërtetohet se kandidati ka paraqitur të dhëna të pavërteta, ose i ka falsifikuar ato, me qëllim përmbushjen e standardeve të përcaktuara nga vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave, për fitimin e saj.
3. Vendimi merret me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve të Komisionit të Dhënies së Gradës Shkencore “Doktor” të njësisë kryesore përkatëse, pas rekomandimit të dhënë nga komisioni ad hoc, i caktuar nga ky Komision, i përbërë nga të paktën 3 (tre) anëtarë të personelit akademik të njësisë kryesore, të kategorisë “Profesor”, të së njëjtës fushë ose fushave të përafërta.
4. Përpara marrjes së vendimit, komisioni ad hoc njofton personin ndaj të cilit ka filluar procedimi:
 - a) për akuzat e ngritura sipas pikës 1 dhe/ose 2 të këtij neni;
 - b) për të drejtën që ai ka për të paraqitur, me shkrim, sqarimet e tij rreth akuzës së ngritur, si dhe një afat të arsyeshëm, deri kur duhet të paraqitet ky sqarim;
 - c) për të drejtën që ka për të inspektuar dosjen e procedimit, për t’u dëgjuar, për të paraqitur dëshmitarë, për të paraqitur prova ose për të kërkuar marrjen e tyre;
5. Pasi komisionit ad hoc t’i jetë vënë në dispozicion informacioni i kërkuar sipas germës b) të pikës 6, të kësaj dispozite, ky i fundit njofton personin ndaj të cilit ka filluar procedimi, për datën kur do të shqyrtohet akuzat e pretenduar, e cila nuk mund të caktohet më shpejt se 5 (pesë) ditë pune dhe jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune, nga marrja e njoftimit.
6. Procesi i verifikimit kryhet në mënyrë të paanshme, gjithëpërfshirëse, konfidenciale, pa cenuar saktësinë dhe objektivitetin e procedimit.

NENI 10 - TARIFA E SHKOLLIMIT

1. Financimi i doktoratës mund të bëhet nga këto burime:

- i. me vetëfinancim nga studenti i doktoratës;
 - ii. nga fondet për kërkim shkencor të njësisë bazë organizuese;
 - iii. nga fondet për kërkim shkencor të njësisë kryesore;
 - iv. nga grantet e punës kërkimore-shkencore, që financohen nga buxheti i shtetit në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi;
 - v. nga institucione të tjera financuese dhe/ose nga burime të tjera publike dhe jopublike.
2. Mënyra e pagesës së tarifës së shkollimit, përcaktohet nga secila njësi kryesore, por në çdo rast me jo më pak se 3 (tre) këste.
 3. Në rast anulimi të gradës shkencore “Doktor”, doktoranti duhet të kthejë vlerën e përfituar të financimit, kur ajo është dhënë nga fonde publike.

NENI 11 - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Çdo mosmarrëveshje midis palëve zgjidhet së pari, me mirëkuptim. Në të kundërt, palët kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës kompetente për zgjidhjen e tyre.

NENI 12 - DISPOZITA TË FUNDIT

Kjo kontratë hartohet në 4 (katër) kopje identike, nga të cilat një kopje për studentin e doktoratës, një kopje për njësinë bazë, një kopje për njësinë kryesore dhe një kopje përcillet në Rektoratin e UMT-së.

PËRGJEGJËSI I PROGRAMIT

DOKTORANTI